

COVID-19 dhe ndikimet e tij në mbrojtjen e fëmijëve online

Prill 2020



COVID-19 ka sjellë mbylljen e shkollave dhe marrjen e masave të distancimit fizik në mbarë botën, dhe i ka shndërruar komunitetet dhe platformat online në mjete të domosdoshme për të ruajtur ndjesinë e normalitetit. Fëmijët dhe familjet e tyre po iu drejtohen zgjidhjeve digjitale më shumë se kurrë më parë për të mbështetur të nxënit, socializimin dhe argëtimin e fëmijëve. Megjithëse zgjidhjet digjitale ofrojnë mundësi të shumta për të mbështetur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve, po këto mjete mund të rrisin edhe ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve në internet. Ky udhëzues teknik përcakton disa nga prioritetet dhe rekomandimet kyçe se si t'i zbutim këto rreziqe dhe se si të promovojmë përvoja pozitive online për fëmijët.

COVID-19 ka ndryshuar papritmas jetën e përditshme të fëmijëve duke krijuar një rutinë të re online

- Deri më 3 prill 2020, COVID-19 ka sjellë **mbylljen e shkollave në** të paktën **188 vende**, duke prekur mbi 90% të popullatës së nxënësve në mbarë botën.
- Në vende ku aksesimi në teknologjinë digjitale është i përhapur, gjithnjë e më shumë aspekte të jetës së përditshme të njerëzve po kalojnë drejt sistemit online, pasi njerëzit zgjedhin ose iu kërkohet të qëndrojnë në shtëpi. Pas shpërthimit të COVID-19, **përdorimi i internetit është rritur me 50%** në disa vende të botës.
- Po ashtu, përvojat e të nxënit të shumë fëmijëve po marrin një trajtë tjetër që nga fillimi i papritur i mësimin në distancë, duke përfshirë, aty ku janë të disponueshme, teknologjinë dhe platformat virtuale si zëvendësuese të klasës dhe mjediseve shkollore.
- Lojërat online, media sociale dhe programet e komunikimit përmes videove (video chat) po **ofrojnë mundësi** për fëmijët që të lidhen dhe të luajnë me shokët, prindërit dhe të afërmit e tyre gjatë izolimit.
- Megjithëse fëmijët **13-vjeçarë ose më të mëdhenj** mund të jenë të familjarizuar tashmë me median sociale, pandemia i ka njohur edhe fëmijët e vegjël me mjetet e rrjetëzimit social, që mund të mos jenë parashikuar për ta dhe për të cilat ata mund të mos kenë përgatitjen e duhur.
- Ndërkohë, prindërve dhe kujdestarëve po iu kërkohet të mbikëqyrin kalimin e fëmijëve të tyre drejt mësimin dhe argëtimin online, duke mbajtur në ekuilibër punën dhe pasiguritë e tjera lidhur me pandeminë.

Shtimi i veprimtarive në internet mbështet të nxënit, socializimin dhe argëtimin e fëmijëve, por ndërkohë i vendos ata përpara një rreziku më të madh

Përdorimi gjithnjë në rritje i internetit mund t'i vendosë fëmijët në rrezik më të madh ndaj lëndimeve online, si shfrytëzimi seksual dhe bullizmi kibernetik. Jo të gjitha rreziqet do të përkthehen në lëndime reale, por fëmijët që përballen me problematika të tjera në jetët e tyre mund të jenë më të cenueshëm. Është e rëndësishme që masat për zbutjen e rreziqeve të balancohen me të drejtat e fëmijëve për lirinë e shprehjes, aksesin në informacion, dhe privatësinë. Mbajtja e fëmijëve të informuar dhe të angazhuar, si dhe aftësimi i tyre për përdorimin e internetit në mënyrë të sigurt është një mënyrë thelbësore e mbrojtjes.

Shfrytëzimi seksual online. Vlerësimi më i fundit **Global i Kërcënimit**, i realizuar nga Aleanca Globale WePROTECT, dhe raportimi investigativ novator, i kryer nga gazeta **"New York Times"**, përcaktojnë shkallën dhe ndikimin e shfrytëzimit seksual online. Ka shumë gjasa që COVID-19 ta rrisë këtë rrezik ndaj fëmijëve, siç **theksohet** nga agjencitë kombëtare ligjzbatuese dhe organizatat e shoqërisë civile në

mbarë botën. Koha më e gjatë e shpenzuar online mund të rrisë gjasat që fëmijët të kenë kontakte me keqbërës në internet. Masat e distancimit fizik kanë gjasa të shtojnë mundësitë që fëmijët të krijojnë kontakte dhe grupe të reja online, të cilat mund të shfrytëzohen nga keqbërës për t'i ndjellë fëmijët për shfrytëzim seksual. Me numrin e lartë të të rriturve të izoluar në shtëpi, mund të ketë edhe rritje të kërkesës për materiale me përmbajtje të abuzimit seksual të fëmijëve, duke çuar në më shumë shfrytëzim seksual komercial të fëmijëve. Transmetimi direkt online i abuzimit seksual nga ana e pjesëtarëve të familjes është po ashtu një fenomen i mirëdokumentuar në komunitete të caktuara. Urdhrat për qëndrimin në shtëpi nënkuptojnë që familjet janë të detyruara të qëndrojnë shumë afër njeri-tjetrit, gjë që për fëmijët që jetojnë me abuzuesit mund të rezultojë në përshkallëzim të abuzimit seksual, si offline ashtu edhe online.

Bullizmi kibernetik. Është gjerësisht e pranuar se bullizmi kibernetik është një shqetësim madhor te adoleshentët dhe ka ndikime negative nga më të ndryshmet. Përballë faktit ku shumë fëmijë po kalojnë papritmas kohë të gjatë dhe të paorganizuar online dhe po përballen me shqetësime në rritje, bullizmi kibernetik mund të shumëfishohet. Pandemia e COVID-19 ka sjellë edhe përdorimin e mesazheve direkte, lojërave online dhe shërbimeve të komunikimit (chat) për një numër të madh të fëmijëve të vegjël, të cilët mund të kenë pak përvojë online dhe mund të jenë më pak rezilientë ndaj sjelljes së dëmshme. Vajzat, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata që konsiderohen të ndryshëm dhe në rrezik më të madh për t'u infektuar ose për të përhapur COVID-19 mund të jenë më shumë të rrezikuar për sa i përket bullizmit dhe diskriminimit online.

Sjella e rrezikshme online. Mungesa e ndërveprimit fizik me shokët dhe partnerët mund të bëjë që fëmijët më të mëdhenj të përfshihen në sjellje të rrezikshme online, si për shembull nëpërmjet dërgimit të mesazheve me përmbajtje seksuale ose ndarjes së përmbajtjes seksuale të vetëgjeneruar, të cilat mund t'i ekspozojnë ata ndaj rreziqeve të shantazhit seksual, ngacmimit dhe poshtërimit.

Përmbajtje potencialisht e dëmshme. Rritja e veprimtarisë online mund t'i ekspozojë fëmijët ndaj përmbajtjes potencialisht të dëmshme dhe të papërshtatshme për moshën, duke përfshirë përmbajtjen që është e dhunshme, misogyniste, ksenofobe, dhe promovon dhunën politike ose ideologjike, ose nxit vetëvrasjen dhe lëndimin e vetes. Gjithashtu, fëmijët mund të ekspozohen ndaj një numri të madh reklamash të synuara online, që promovojnë ushqimet e pashëndetshme, stereotipat gjinore ose që janë të papërshtatshme për moshën. Ata mund të ekspozohen edhe ndaj keqinformimit rreth pandemisë së COVID-19, i cili mund të shkaktojë më shumë frikë dhe ankth.

Mbledhja, përdorimi dhe shpërndarja e papërshtatshme e të dhënave. Kalimi i jetës së fëmijëve online, duke përfshirë teknologjinë arsimore, mund të rezultojë në shtimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të fëmijëve nga ana e shoqërive, krahas ekspozimit të shtuar në përmbajtjen dhe teknikat e marketingut digjital. Kjo mund të prekë fëmijët nën moshën 13-vjeçare, privatesia e të cilëve mbrohet me ligj.¹

Mbrojtje e kufizuar e fëmijëve online. Me nxitimin për të mundësuar mësimin në distancë, shkollat mund të mos kenë politikat e duhura të mbrojtjes së fëmijëve për rregullimin e komunikimit të nxënësve dhe mësuesve nëpërmjet rrjeteve private dhe mjeteve të tjera online. Prindërit dhe kujdestarët mund të mos jenë të informuar për politikat e çdo shkolle, nëse ka të tilla, dhe mund të mos jenë të ambientuar me teknologjitë e reja, gjë që e kanë të vështirë për t'i angazhuar fëmijët e tyre në një diskutim se si të qëndrojnë të sigurtë në internet.

¹Për shembull COPPA dhe GDPR-K.

Qeveritë, shoqëritë, shkollat dhe prindërit duhet të punojnë bashkërisht për të siguruar që përvojat online të fëmijëve të jenë të sigurta dhe pozitive

Garantimi i sigurisë online të fëmijëve gjatë pandemisë së COVID-19 kërkon veprime urgjente të bashkërenduara nga ana e prindërve dhe kujdestarëve, autoriteteve shkollore, shoqërive dhe ofruesve të teknologjisë digjitale, punonjësve të shërbimit social dhe qeverive.

1. Fuqizoni fëmijët online

- Prindërit dhe kujdestarët, autoritetet shkollore, shoqëritë e teknologjisë digjitale, ofruesit mediatikë, punonjësit e shërbimit social dhe qeveritë duhet të kuptojnë se fëmijët janë agjentë të ndryshimit dhe se duhet të pajisen me njohuritë dhe informacionin e nevojshëm për të orientuar jetën e tyre online në mënyrë të sigurt gjatë krizës së COVID-19 dhe pas saj.
- Mesazhet, informacionet dhe këshillat për lundrimin në botën digjitale duhet të synojnë fëmijët në atë mënyrë dhe nëpërmjet kanaleve të përshtatshme për ta. Për më tepër, fëmijët duhet të informohen se si të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje.
- Gjithashtu, fëmijët duhet të nxiten që të shprehin mendimin e tyre online në mbështetje të tjerëve në nevojë për ndihmë gjatë kësaj krize. Pikëpamjet e fëmijëve duhet t'iu shërbejnë përmirësimeve në platforma dhe ndryshimeve të tjera që kanë për qëllim t'i mbajnë ata të angazhuar dhe të sigurtë gjatë kësaj emergjence që po përparon me shpejtësi. Qeveria dhe ofruesit e shërbimit social duhet të përfshijnë **zërin e fëmijëve** dhe t'i angazhojnë fëmijët në mënyrë aktive në politikëbërjen lidhur me ta.

2. Mbështetni prindërit dhe kujdestarët për t'i ndihmuar fëmijët që të qëndrojnë të sigurtë online

- Prindërit dhe kujdestarët mund t'i ndihmojnë fëmijët që të aksesojnë burimet online, të domosdoshme për mësimin online, socializimin dhe argëtimin në periudhën e pandemisë së COVID-19. Njëkohësisht, prindërit dhe kujdestarët duhet të tregohen vigjilentë ndaj **rreziqeve online** ndaj fëmijëve. Qeveritë, shoqëritë dhe aktorë të tjerë duhet t'i mbështesin prindërit me **udhëzime dhe mjete** të përshtatshme, duke përfshirë mënyrën se si të reagojnë dhe, nëse është nevoja, se si të raportojnë kontaktet, sjelljen dhe përmbajtjen e dëmshme.
- Prindërit dhe kujdestarët mund të vendosin me fëmijët e tyre rregulla se si, kur dhe ku mund të përdoret interneti. Për të vendosur një ekuilibër të shëndetshëm ndërmjet kohës online dhe veprimtarive të tjera duhet të përcaktohen disa kufij. Po ashtu, prindërit dhe kujdestarët duhet të sigurojnë që pajisja/pajisjet e fëmijëve të tyre të kenë përditësimet më të fundit të softuerit dhe programet e antivirusit, dhe të garantojnë se niveli i privatësisë në cilësimet të jetë përzgjedhur si 'i lartë'. Në rastin e fëmijëve të vegjël, veprime si kontrollat prindërore mund të ndihmojnë në zbutjen e rreziqeve online.
- Prindërit dhe kujdestarët mund të diskutojnë hapur me fëmijët e tyre se si dhe me kë komunikojnë fëmijët online. Fëmijët duhet të dinë se ndërveprimet e sjellshme dhe mbështetëse janë të pranueshme, ndërsa kontakti i dëmshëm, **diskriminues** ose i papërshtatshëm nuk është i pranueshëm kurrsesi. Fëmijët duhet të kenë vetëbesim për t'i treguar menjëherë një të rrituri të besuar kur ndodh diçka shqetësuese ose e papërshtatshme.
- Prindërit dhe kujdestarët mund t'i ndihmojnë fëmijët që të bëjnë dallimin ndërmjet përmbajtjes së rregullt dhe reklamave, dhe të bisedojnë me ta me qëllim përballjen e duhur ndaj mesazheve

negative.

- Prindërit dhe kujdestarët duhet të tregohen vigjilentë ndaj shenjave shqetësuese që mund të shfaqen në lidhje me veprimtarinë online të fëmijëve. Për shembull, nëse një fëmijë përjeton bullizëm kibernetik, ai mund të shfaqë shenja paralajmëruese, si përdorimi më i shpeshtë ose më pak i shpeshtë i pajisjes së tij, ose të qenit i tërhequr ose i shqetësuar. Qeveritë, shoqëritë dhe administratorët e shkollave duhet t'i njohin prindërit dhe kujdestarët me politikat përkatëse, si dhe me mekanizmat online dhe offline të raportimit. Prindërit duhet të kenë në dispozicion numrat mbështetës të linjave të dobishme telefonike dhe të ndihmës, dhe të kontaktojnë policinë nëse shqetësimi i fëmijëve të tyre lidhet me kërcënime, krime të mundshme ose sjellje të tjera të paligjshme.

3. Mundësoni një përvojë të sigurt për nxënësit gjatë mësimit online

- Shkollat duhet të hartojnë ose përditësojnë **politikat** e tyre aktuale të **mbrojtjes** për të pasqyruar realitetin e ri për fëmijët që mësojnë nga shtëpia. Ndërveprimet online midis stafit të shkollës dhe nxënësve duhet të jenë transparente dhe të rregulluara. Masat specifike të mbrojtjes mund të përshtatshme kur janë përballë kamerës së kompjuterit (webcam) dhe të mos lidhen me mësuesit e tyre ose me klasat virtuale nga dhoma e gjumit; dhe të shmangët përdorimi i shërbimit të mesazheve direkte në komunikimet mësues-nxënës, ose kërkimi i miratimit të prindërve për këto seanca. Gjithashtu, shkollat duhet të miratojnë mekanizma të sigurisë digjitale për të siguruar që vetëm individët e autorizuar të kenë akses në platformat e mësimit online, dhe që këto platforma të mos regjistrojnë dhe ruajnë automatikisht seancat e mësimit virtual.
- Shkollat duhet t'i komunikojnë qartësisht politikat e sigurisë online dhe **të ofrojnë burime** dhe informacion rreth sigurisë digjitale, për të mbështetur prindërit dhe kujdestarët në krijimin e një përvojë pozitive të mësimit online, si për shembull **Interland**, **internetmatters.org**, **NSPCC** dhe **Childnet International**.
- Shkollat duhet t'u komunikojnë qartësisht të gjithë nxënësve kodin e pritshëm të sjelljes lidhur me platformat dhe komunikimet digjitale, siç pritet nga ata të sillen në ambientet fizike të shkollës. Ato duhet të promovojnë dhe monitorojnë sjelljen e mirë online ndërmjet nxënësve. Shkollat duhet të jenë të informuara se, sidomos fëmijët e vegjël mund të mos i kenë zhvilluar ose praktikuar këto aftësi më përpara, dhe mund të lëndojnë të tjerët pa dashje. Bullizmi në mjediset e shkollës ndërmjet shokëve të klasës mund të shndërrohet lehtësisht në bullizëm kibernetik, dhe autoritetet shkollore duhet t'i përshtatin rregulloret dhe politikat kundër bullizmit në hapësirat online, dhe t'ia bëjnë ato të qarta nxënësve dhe prindërve.
- Shkollat duhet të sigurojnë që fëmijët të kenë akses të pandërprerë në shërbimet e këshillimit të ofruara nga shkolla. Në mungesë të kontaktit fizik me këshilluesit, fëmijët e shqetësuar duhet të kenë mjete konfidenciale të sigurta për të marrë mbështetje online ose nëpërmjet telefonit. Gjatë pandemisë së COVID-19, një periudhë gjatë së cilës fëmijët mund të përjetojnë probleme familjare, dhunë në familje ose rritje të ndjesive të pasigurisë dhe ankthit, mund të ketë rritje të nevojës për shërbime këshillimi. Vajzat, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata që konsiderohen të ndryshëm ose në rrezik më të madh për t'u infektuar ose për të përhapur COVID-19 mund të përjetojnë më shumë ankth, gjë që kërkon mbështetje shtesë. Shkollat duhet të promovojnë **linjat telefonike** të posaçme për vendin ose platformat e këshillimit online. Gjithashtu, shkollat duhet të përditësojnë udhëzime për mësuesit lidhur me identifikimin dhe raportimin e abuzimit ose neglizhimit të fëmijëve nëpërmjet komunikimeve virtuale.

4. Mundësoni platforma online të sigurta dhe të aksesueshme për fëmijët

- Për të shmangur thellimin e pabarazive gjatë pandemisë, shoqëritë e teknologjisë duhet të punojnë bashkë me qeveritë për të përmirësuar aksesin në pajisjet digjitale dhe lidhjen në internet për fëmijët e pafavorizuar, duke përfshirë ata që janë të prekur nga varfëria, ata të ndarë, në lëvizje, me aftësi të kufizuara, në mjedise ku mbizotëron dhuna në familje, në mjedise konflikti, si edhe ata që mund të kenë humbur prindërit ose kujdestarët parësorë gjatë pandemisë. Platforma e re Globale e Reziliencës së Rrjetit të ITU-s (#REG4COVID) është një mjet për autoritetet rregullatore, autoritetet qeveritare dhe industrinë për të ndarë dhe bashkuar përvojat, iniciativat në vazhdim dhe masat novatore rregullatore dhe të politikave të parashikuara për t'iu siguruar akses komuniteteve (dhe fëmijëve) në internet. Shoqëritë e teknologjisë duhet të vënë në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve burime të mësimit online falas ose me kosto mjaft të reduktuar. Operatorët telefonikë duhet të konsiderojnë ofrimin falas të burimeve të mësimit online dhe të informacionit shëndetësor për COVID-19.
- Është domosdoshmëri që veçoritë e sigurisë së shtuar të inkorporohen në të gjitha pajisjet, duke përfshirë ato që vihen në dispozicion me kosto të ulët ose ato pa kosto, dhe që prindërit dhe kujdestarët të udhëzohen se si t'i aktivizojnë këto veçori.
- Shoqëritë që po zhvillojnë dhe po përdorin klasa virtuale dhe platforma të tjera specifike të mësimit online duhet të sigurohen që **veçoritë e sigurisë të integrohen dhe përmirësohen**, dhe të jenë lehtësisht të aksesueshme nga mësuesit, prindërit dhe nxënësit. Mbledhja e të dhënave dhe praktikave të tjera komerciale duhet të jenë transparente, të përgjegjshme dhe të pasqyrojnë rregulloret dhe ligjet kombëtare/ndërkombëtare. Platformat e rrjetëzimit social, të përdorura për ndërveprimet mësues-nxënës, duhet të përdorin masat përkatëse të mbrojtjes për fëmijët, duke i lejuar mësuesit të ushtrijnë funksionet e tyre në mënyrë të përshtatshme. Për më tepër, platformat online që përdorin shërbimet e videokonferencave, të cilat po përdoren gjithnjë e më shumë për seancat ndërvepruese online, duhet të sigurojnë që janë vendosur kufizime mbrojtëse lidhur me sigurinë dhe privatësinë.
- Shoqëritë duhet të përdorin platformat e tyre për të promovuar dhe lehtësuar shërbimet e referimit për sigurinë fëmijëve dhe linjat e ndihmës për rreth **1.5 miliardë fëmijë** dhe të rinj, aktualisht jashtë shkolle, disa prej të cilëve mund të jenë në rrezik të madh nga stresi psikosocial, dhuna dhe shfrytëzimi. Kjo përfshin ndarjen e informacionit lidhur me shërbimet e referimit dhe shërbime të tjera mbështetëse të disponueshme për të rinjtë, si Linjat Kombëtare të Këshillimit për Fëmijët. Shoqëritë sugjerohet që të rrisin kapacitetin e linjës së këshillimit për fëmijët me infrastrukturë të bazuar në sistemin "cloud", dhe duke shfrytëzuar Reagimin Interaktiv me Zë (Interactive Voice Response - IVR) / sistemet "bot" për të automatizuar pyetjet e linjës telefonike të këshillimit. Operatorët telefonikë duhet të vënë në dispozicion numra të ndihmës ose të mundësojnë thirrje pa pagesë, duke hequr tarifat e lidhjes dhe duke promovuar burimet e referimit dhe linjës telefonike për fëmijët.
- Duke qenë se pandemia po i orienton fëmijët e vegjël drejt mësimit online dhe rrjeteve sociale (disa për herë të parë), shoqëritë duhet të bëjnë përpjekje të rëndësishme për t'i ndihmuar ata, dhe prindërit e kujdestarët e tyre, që të mësojnë të përdorin **burimet online në mënyrë të sigurt**. Kjo përfshin:
 - Përshtatjen e burimeve të sigurisë online për grupmosha të ndryshme dhe lehtësimin e aksesueshmërisë së këtyre burimeve në platformat e tyre, për t'i informuar fëmijët, prindërit dhe kujdestarët mbi rreziqet online dhe për të ofruar akses në shërbimet mbështetëse.
 - Ofrimin e zgjidhjeve dhe mjeteve teknike me udhëzime të qarta dhe lehtësisht të përdorshme (p.sh. 'kontrollat prindërore'), të cilat mund t'i fuqizojnë prindërit dhe kujdestarët për t'i ndihmuar fëmijët e tyre që të përdorin teknologjinë digjitale në përshtatje me moshën e tyre.
 - Zgjerimin e shërbimit të mesazhimit lidhur me sjelljen e sigurt dhe të përgjegjshme online, dhe mbështetjen e fëmijëve për të zhvilluar aftësitë e 'reziliencës digjitale' – me fjalë të tjera, njohuri se si të lundrojnë dhe reagojnë ndaj rreziqeve.

5. Forconi shërbimet kombëtare të parandalimit, reagimit dhe mbështetjes

- Qeveritë duhet të monitorojnë në mënyrë aktive se si lëvizja e kufizuar dhe izolimi mund të përkeqësojnë forma të ndryshme të dhunës, si offline ashtu edhe online, duke shfrytëzuar të dhënat më të fundit dhe **modelet ekzistuese** për mbështetjen e politikave. Qeveritë duhet të zbatojnë rregulloret ekzistuese dhe të forcojnë zbatimin e ligjit për të lehtësuar monitorimin dhe reagimin ndaj shtimit të rreziqeve online.
- Qeveritë duhet të alokojnë burime të mjaftueshme për të mbështetur, trajnuar dhe pajisur punonjësit bazë të mbrojtjes së fëmijës, për të siguruar që ata të vazhdojnë të garantojnë sigurinë e fëmijëve gjatë gjithë kohëzgjatjes së pandemisë. Sa herë që është e mundur, shtetet duhet të vijojnë ofrimin e mbështetjes në qendra dhe nëpërmjet vizitave në shtëpi për personat e prekur rëndë, ose të përshtatin dhe të ofrojnë shërbime sociale në mënyrë virtuale.
- Qeveritë duhet t'i trajnojnë punonjësit e shërbimit shëndetësor, arsimor dhe social lidhur me ndikimet që pandemia e COVID-19 mund të ketë në mirëqenien e fëmijëve, duke përfshirë shtimin e rreziqeve online. Ata që ofrojnë mbështetje psikosociale/të shëndetit mendor të vijës së parë duhet të jenë të aftësuar për të folur me fëmijët rreth pandemisë së COVID-19, dhe për të adresuar ankthin dhe pasigurinë e tyre. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar fëmijëve më të cenueshëm, duke përfshirë ata të ndarë, në lëvizje, me aftësi të kufizuara, në mjedise konflikti dhe ata që mund të kenë humbur prindërit ose kujdestarët parësorë gjatë pandemisë.
- Qeveritë duhet të jenë të informuara për shtimin e rreziqeve të mundshme online ndaj fëmijëve gjatë pandemisë, dhe duhet të kërkojnë t'i adresojnë ato nëpërmjet shtimit të monitorimit dhe zbatimit të rregulloreve ekzistuese. Agjencitë ligjzbatuese duhet të mbështeten për të monitoruar një rritje të mundshme në sjelljet kundërvajtëse online, dhe të sigurojnë funksionalitetin për të reaguar ndaj tyre.
- Qeveritë duhet të sigurojnë që ofruesit e shërbimit social, shkollat, prindërit, kujdestarët dhe fëmijët të jenë të informuar për mekanizmat vendase të raportimit, dhe që të kenë numrat mbështetës të linjave vendase telefonike dhe të ndihmës. Nëse ato nuk ekzistojnë, duhet të vendosen linja vendase telefonike dhe të ndihmës për të mbështetur fëmijët që përjetojnë ankth. Rrjetet më të mëdha ndërkombëtare të raportimit përfshijnë **Linjat telefonike INHOPE** dhe **portalet IWF**. Fëmijët mund të gjejnë mbështetje direkte nëpërmjet **Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijët**. Publiku duhet të këshillohet që të kontaktojë policinë kur paraqitet rrezik i pashmangshëm.
- Në përpjekjet për t'i lidhur fëmijët në burimet e mësimin online, socializimin dhe argëtimin, qeveritë duhet të ndërmarrin iniciativa edukuese lidhur me sigurinë e fëmijëve online. Këto duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin lidhur me burimet dhe rreziqet online, duke përdorur median dhe kanalet e tjera të komunikimit për shpërndarjen e mesazheve kyçe.

Burime shtesë

Udhëzime prindërimi për të garantuar sigurinë e fëmijëve online gjatë pandemisë së COVID-19

www.unicef.org/press-releases/covid-19-children-heightened-risk-abuse-neglect-exploitation-and-violence-amidst

www.unicef.org/coronavirus/covid-19-parenting-tips

www.end-violence.org/protecting-children-during-covid-19-outbreak

en.unesco.org/covid19

www.unicef.org/coronavirus/covid-19

www.itu.int/en/Pages/covid-19.aspx

www.childhood-usa.org/resources

www.unodc.org/unodc/en/covid-19.html